



REPUBLIKA E SHQIPËRISE
KËSHILLI I BASHKISË
KORÇË

VENDIM
Nr 163 Datë 30.11.08

PER
Miratim fondi për shpërblim Korit "LIRA" dhe banda e qytetit pranë Qendrës
ekonomike të Kulturës "Vangjush Mio"

Këshilli i Bashkisë i qytetit të Korçës, i mbledhur në datën e sotme, pasi mori në shqyrtim relacionin e paraqitur nga Drejtoria e Finances « Miratim fondi për shpërblim Korit LIRA dhe banda e qytetit pranë Qendrës ekonomike të Kulturës », bazuar në ligjin nr. mbi 8652 dt. 31.07.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore" nën 32 pika dh, ligjin nr.9836 dt. 26.11.2007 « Per buxhetin e Shtetit te vitit 2008 », Udhezimin nr.4 dt.17.01.08 i M.F « Per zbatimine buxhetit te shtetit per vitin 2008 ».Udhezimin nr 258 dt. 15.02.2008 i Ministrise se Brendshme « Per zbatimin e buxhetit te qeverisjes vendore per vitin 2008 ». V.K.B nr. 12 dt. 18.03.2008 « miratimin e buxhetit te Bashkise dhe institucioneve te vartesise per vitin 2008 », Ligji nr. 9936 date 26.06.2008 « Per menaxhimin e sistemit buxhetor ne Republiken e Shqiperise » mbështetur në kompetencat që ka si dhe mbas diskutimit të anëtarëve:

VENDOSI

- 1.Të miratoje fondin me vlerën prej 165.000 lekë për shpërblimin e pjesëtarëve të Korit « LIRA » (33 persona * 5.000 lekë)
2. Të miratoje fondin me vlerën prej 135.000 lekë për shpërblimin e Bandës së qytetit pranë Qendrës ekonomike të Kulturës «Vangjush Mio» (27 persona * 5.000 lekë)
3. Ky fond do të përballohet nga fondi rezervë i të ardhurave të Bashkisë me kete strukture buxhetore :

Pakësohet	00	04980	05	Art	6090000	- 300 000
Shtohet	00	08250	05	Art	6020000	+ 300 000

4.Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Financës dhe Qendra ekonomike të Kulturës.

5.Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Kryetari

Raimonda Nase